



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/ MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/77;
Datë: 26.02.2016 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut; nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015 (Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komunë); nenit 16 paragrafi 9 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 paragrafi 8.1. të Rregullores mbi transparencën, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 26.02.2016 nxjerrë:

V E N D I M
për hapjen e diskutimit publik për
projekt Planin komunal për eficiencë të energjisë në komunën e Junikut

- I.** Me këtë vendim **hapet diskutimi publik** për projekt Planin për eficiencë të energjisë në komunën e Junikut/në tekstin e mëtejme projekt Plani/.
- II.** Projekt Plani nga pika I. e këtij vendimi vihet në dispozicion të publikut për shqyrtim publik dhe komente.
- III.** Të gjitha propozimet dhe vërejtjet që paraqiten nga publiku brenda afatit kohor prej 15 ditëve do të përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
- IV.** Ekspozimi i projekt Planit do të bëhet në zyrën e inspektionit e cila gjendet në kuadër të objektit të Komunës së Junikut.
- V.** Diskutimi publik i projekt Planit zgjat 15 ditë.
- VI.** Gjatë kohës së diskutimit publik projekt Plani ekspozohet edhe në ueb faqen e Komunës së Junikut për shqyrtim dhe komente.
- VII.** Diskutimi publik i projekt Planit organizohet nga Komuna e Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim.
- VIII.** Organizatori është i obliguar që të hartojë planin e veprimit dhe organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së diskutimit publik të këtij projekt Plani.
- IX.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim .

X. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

XI. Vendimi iu dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës së Junikut;
2. Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojte dhe Shpëtim;
3. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
4. Shërbimit të Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivit të Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ _____
kryesues